



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

RAPORT VJETOR

2025

SHKURTIME

AEM	“Agjencia Ekonomike Mbështetëse - AEM” sh.p.k.
Agregatori	“AGREGATORI - Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje”
AMI	“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve - AMI” sh.p.k.
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
HUBEX	“HUBEX - Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion”
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKZHRK	Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin
KM	Këshilli i Ministrave
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
ORRT	“Operatori i Rrugëve Rurale Turistike - ORRT” sh.b.b.
PO	Programi Operacional i FSHZH
PIUTD	Project for Integrated Urban and Tourism Development (Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban & Turistik)
QSH	Qeveria Shqiptare
ZHRK	Zhvillimi Rajonal & Kohezioni

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një organizatë me eksperiencë mbi 30-vjeçare në zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke iu përgjigjur sfidave dhe partnerëve të saj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. FSHZH manaxhon një portofol vjetor operacionesh dhe programesh në vlerën rreth €250mln, me një ekip të përbërë prej mbi 170 profesionistësh të disiplinave të ndryshme, të pozicionuar në Tiranë dhe në 4 zyrat rajonale të zhvillimit në Shqipëri. Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit bazë nr. 10130, datë 11.5.2009, FSHZH synon përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike vendore, përmirësimin e shërbimeve publike vendore, forcimin institucional të NJVV-ve si dhe nxitjen e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Ligji 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, duke përcaktuar FSHZH-në si *Sekretariat* i Komitetit Kombëtar si dhe i Bordeve të Monitorimit, i ngarkon një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të zhvillimit rajonal nga njëra anë, dhe nga ana tjetër cakton FSHZH-në si *Autoritet Menaxhues* me përgjegjësinë për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe arritjen e objektivave e treguesve të matshëm të tij. Gjatë vitit 2025 ka vazhduar puna në kuadër të zbatimit të këtij roli të FSHZH-së përgjatë gjithë ciklit të jetës së zhvillimit, si një organizatë që: (i) mbështet hartimin e politikave të zhvillimit rajonal; (ii) ka një rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit; (iii) menaxhon dhe implementon në bashkëpunim me NJVV-të programet dhe projektet zhvillimore; (iv) mbështet hyrjen në treg si një operator zhvillimi, duke ngritur dhe vënë në funksionim modele të integruara zhvillimi në partneritet me njësitë vendore.

Për t’iu përshtatur këtyre ndryshimeve, gjatë vitit 2025 vazhdoi konsolidimi i ndarjes së funksioneve sipas organizimit strukturor të FSHZH, përfshirë operatorët e zhvillimit të aplikuar, nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejt në praktikë të rolit të tyre përmes aktiviteteve respektive, duke synuar fokus dhe impakt optimal për kohezion dhe zhvillim rajonal.

Në këtë drejtim, gjatë vitit raportues u vijua zbatimi i Programit Operacional afatgjatë 7-vjeçar (2022-2028 dhe 2024-2030) dhe u përditësua programimi afatmesëm në funksion të dinamikës së portofolit dhe prioriteteve të zhvillimit rajonal. Fokus i punës ishte konsolidimi i planifikimit sipas

6 drejtimeve kryesore të veprimtarisë, përmes rishikimit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve, me qëllim rritjen e koordinimit dhe sinergjisë së investimeve në territor. Ky proces u zhvillua në përputhje me rolin si *Autoritet Manaxhues* i përcaktuar nga kuadri ligjor, duke integruar aktivitetin e organizatës në një logjikë programatike të unifikuar, e cila përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Në zbatim të PO 2022-2028 dhe 2024-2030 është punuar për formësimin dhe vlerësimin e projekteve për t'u implementuar nëpërmjet financimit të brendshëm në kuadër të zbatimit të PO dhe detajimeve afatmesme, si edhe nga financimi i huaj sipas programeve specifike në zbatim. Lidhur me detajimin e PO '24-'26, gjatë vitit 2025, janë formësuar 271 projekte me vlerë totale investimi 16.623 mld lekë me financim nga buxheti i shtetit. Gjithashtu, ka përfunduar procesi i formësimit nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve për 15 ndërhyrje me vlerë totale investimi prej 1.66 mld lekë me financim të huaj, nëpërmjet programeve AITP, PIUTD si dhe janë në proces formësimi 3 projekte të integruara specifike në zonën e Pogradecit, pjesë e financimit të KfW dhe 1 ndërhyrje pjesë e financimit të Projektit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale (BERZH).

Janë menaxhuar rreth 650 kontrata për të gjithë programet e financimit dhe ecuria e programeve në zbatim arrin vlerën rreth 24.671 mld lekë ose në masën 99.1% e shpërndarë sipas komponentëve të secilit program. 7 programe janë me financim të huaj (rreth 6.929 mld lekë), 3 programe me financim të brendshëm (rreth 17.775 mld lekë), si edhe ai i rindërtimit me 180.433 milionë lekë.

Janë kontrolluar 86 projekte zhvillimi, të cilat ndjekin miratimin dhe më pas vijojnë procesin e detajimit dhe prokurimit. FSHZH ka siguruar oponencë teknike për 46 projekte zbatimi. Është përgatitur dokumentacioni dhe është aplikuar për pajisjen me lejet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për 200 objekte (136 leje të miratuara dhe 64 në proces). Gjatë vitit 2025 kanë qenë në proces dhe janë ndjekur punimet e zbatimit të projekteve për zhvillim, për rreth 446 objekte me vlerë 68.46 mld lekë (prej të cilave 294 objekte me vlerë 20.84 mld lekë kanë përfunduar punimet). 515 objekte janë marrë në dorëzim përfundimtar nga NJVV, ndërsa 86 objekte në dorëzim të përkohshëm.

Në total, buxheti 2025 është realizuar në masën 99.1% dhe janë kryer mbi 15,000 transaksione financiare. Duke konsideruar ndryshimet nga aktet normative apo vendimet e Këshillit të Ministrave, buxheti i rishikuar i FSHZH-së bëhet 24.88 miliardë lekë nga të cilat realizuar 24.67 miliardë lekë, ndarë sipas programeve: (i) me Financim të Huaj 6.93 miliardë lekë; (ii) me Financim të Brendshëm 17.72 miliardë lekë; (iii) Programi i Rindërtimit rreth 21 milionë lekë.

Janë ndjekur 304 procedura prokurimi, ku vlera e kontratave të nënshkruara gjatë 2025 rezulton në total 14.7 mld lekë me tvsh. Rreth 71.4% të kësaj vlere, e zënë kontratat në zbatim të programit të investimeve të QSH dhe rreth 28.6% kontratat në zbatim të programeve me financim të huaj.

FSHZH përmes Departamentit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit, në 2025 është angazhuar për çuarjen përpara të Reformës së Zhvillimit Rajonal, për zhvillim koheziv kombëtar, koordinim më të mirë horizontal e vertikal të politikave sektoriale dhe lokale, por edhe si pjesë e detyrimit për përbushjen e kërkesave për anëtarësim në BE, që lidhen drejtpërdrejt me Kapitullin 22, “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” të negociatave të anëtarësimit. Dokumentet planifikues dhe programues në nivel kombëtar në zbatim të ligjit 102/2020, duhet fillimisht të miratohen nga KKZHRK dhe më pas nga KM, me këtë rend kronologjik: (i) Politika Kombëtare për ZHRK-draftuar/proces konsultimi; (ii) Plani Kombëtar-draftuar/proces konsultimi; (iii) Planet Rajonale; (iv) Programi Operacional. Referuar akteve nënligjore në zbatim të ligjit 102/2020, janë përgatitur amendime/rishikime për 2 akte, 5 akte janë në fazë përmbyllëse/konsultimi dhe përcillen për miratim pranë Këshillit të Ministrave, ndërsa 1 në proces hartimi/draftimi.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar disa modele të zhvillimit të aplikuar si produkt i angazhimit nga Departamenti i Zhvillimit të Aplikuar dhe Partneritetit, duke rezultuar në projekte transformuese dhe inovatore që nxisin zhvillimin e modeleve të reja të suksesshme. Referuar veprimtarisë së organizatës FSHZH, mirëfunksionimi mbështetet edhe në aktivitetet e 5 operatorëve/subjektet e saj (AEM, AMI, HUBEX, AGREGATORI, ORRT) të ngritur sipas vendimeve të Këshillit Drejtues dhe të konsoliduar tashmë sipas fushës së zhvillimit dhe aktivitetit që mbulojnë.